

# #INNO4EDU

## Titulli i aktivitetit

Tregu matematikor

## Mosha

Periudha zhvillimore (nga mosha 7 deri në 8 vjeçe)

## Hapësira / lokacioni

Kushte shtëpie

## Vlera e karakterit

Të menduarit logjik

## Koha e nevojshme për përgatitje

20 minuta

## Koha e nevojshme për realizim

20 minuta

## Qëllimet

Qëllimi është që fëmija të dijë t'i kuptojë detyrat e thjeshta tekstuale, të përcaktojë cilat operacione nevojiten për zgjidhjen e tyre dhe t'i prezantojë me ndihmën e sendeve ose vizatimeve.

## Rezultatet e pritshme

Fëmija duhet t'i kuptojë detyrat e thjeshta tekstuale, të përcaktojë cilat operacione janë të nevojshme për zgjidhjen e tyre dhe t'i prezantojë me ndihmën e sendeve ose vizatimeve.

## Kahje

### Përgatitje paraprake për aktivitet

Prindi përgatit kartela me detyra, ndërsa fëmija përgatit monedha dhe kartmonedha të letrës me vlerë të ndryshme (1, 2, 5, 50, 100 denarë).

Fëmija bashkë me anëtarët e familjes bëjnë një tezgë si një treg të improvizuar në tavolinë (mundet nga fruta natyrorë dhe shporta ose aplikacione dhe kuti kartoni).

### Instrukcione/kahje për lojën

Fëmijës i shpjegohet se çdo detyrë duhet ta bëjnë si lojë në treg me blerës dhe shitës me lojë të roleve dhe zgjidhjen e detyrave të dhëna.

Detyrat mund të jenë vetëm si shembull, ndërkaq nëse fëmijët duan të vazhdojnë me lojën



mund të shkruhen edhe detyra tjera.

### **Aktivitet/lojë**

Bashkë me fëmijën vendoset tavolina si një tezgë në treg. Me numratore zgjidhet se kush do jetë shitës e kush blerës. Blerësi zgjedh një nga kartelat me detyrë tekstuale dhe ia lexon **blerësit///shitësit///**. Bashkë përpiqen ta zgjidhin detyrën dhe rezultatin e prezantojnë me vizatim ( për shembull të vizatohen sa mollë duhet të shtohen në shportën e detyrës së parë).

Pasi të përfundojnë pyetjet e kartelave, fëmijët nxiten që në mënyrë të pavarur të shpikin detyrë tekstuale dhe të vizatojnë imazhe përkatëse për zgjidhjen e saj.

Shtesa	Materiale
<u>Shtesa nr. 1</u>  Kartela me detyra	  Fruta të ndryshme dhe perime; kuti; fletë letre; pajisje për të shkruar; ngjyra; gërshtë.
<b>Aktiviteti është përgatitur nga:</b>	
Edukatorë: Sonja Çallovska, Vesna Peceva  Dizajn grafik: Katerina Nikolovska  Lekturë: Jana Mihajlovska  Përkthim: Agim Leka	



# Tregu matematikor

## Shtesa nr. 1

1. Sa mollë duhet të shtosh në shportën që ka vetëm një mollë, që ajo të ketë 7 mollë?

Cili është ai numër?

.....

2. Bleva domate për 25 denarë, dy tranguj për 15 denarë dhe mollë për 10 denarë. Sa duhet t'ju paguaj për to?

Sa denarë gjithsej shpenzoi blerësi?

.....

3. Një arkë nxë 55 kumbulla, ndërsa në të ka vetëm 20 kumbulla. Edhe sa kumbulla duhet të vërë shitësi për ta shitur arkën plot me kumbulla ?

.....

4. Në shportën e vogël ka 9 dredhëza. Sa dredhëza duhet të vihen në shportën e madhe për të pasur gjithsej 100 dredhëza në të dy shportat?

.....

5. Nëse largësia nga shtëpia deri te tregu është 10 km, sa është largësia nga shtëpia detri te tregu dhe prapa?

.....